MURTAJA AFRIKANE E DERRAVE

# JU MUND TA FRENONI MAD

**Murtaja Afrikane e Derrave (MAD) është një sëmundje vdekjeprurëse virale e derrave të egër dhe të butë.** Është një kërcënim serioz për shëndetin e derrave pasi nuk ka një vaksinë apo trajtim efektiv kundër saj. MAD nuk përbën rrezik për shëndetin e njeriut, por mund të ketë pasoja katastrofike socio-ekonomike në industrinë e mbarështimit të derrave.

**Veterineri, luan një rol madhor në mbrojtjen nga kjo sëmundje fatale tek fermat për mbarështimin e derrave.**

## SI TË IDENTIFIKONI MAD

Shenjat klinike përfshijnë:




Rritje të numrit të ngordhjeve



### MAD MUND TË NGJAJË SI

- Murtaja klasike e derrave (MKD)
- Sindromi riprodhues dhe respirator i derrave (PRRS)
- Fruthi i derrave (Erisipeloza)
- Salmoneloza (dhe septisemi të tjera bakteriale)
- Sëmundja Aujeszky (ose pseudotërbimi)
- Pastereloza
- Helmimet
- Dermatiti i derrave dhe sindroma e nefropatisë (PDNS)

## HAPAT PËR KONFIRMIMIN E DIAGNOZËS DHE TESTET LABORATORIKE

Mostrat e rekomanduara: gjak ose serum, organe, inde (nga shpretka, nyjet limfatike, bajamet, mushkëritë, veshka dhe palca e kockave).

Ndiqni praktikat e mira të kampionimit:

- Merrni mostrat në mënyrë aseptike dhe lani duart para dhe pas kampionimit.
- Trajtojeni me kujdes mostrën për të shmangur degradimin, kontaminiminose rrjedhjet.
- Vendosni mostrën në qese të posaçme dhe paketojeni sipas udhëzimeve laboratorike.
- Dërgojeni në laboratorin diagnostikues sa më shpejt.

## ÇFARË DUHET BËRË NËSE DYSHONI OSE KONFIRMONI MAD NË FERMË

- **NJOFTONI** autoritetet shtetërore të shëbimit veterinar sa me shpejtë
- **MBLIDHNI** informacion epidemiologjik kyç për fermën dhe kafshët.
- **KARANTINONI** fermat e infektuara ose të dyshuara
- **PARALAJMERONI** fermerët fqinjë
- **SHMANGNI VIZITAT** në fermat e tjera për të paktën 48 orë

Food and Agriculture Organization of the United Nations

WORLD ORGANISATION FOR ANIMAL HEALTH

Në kuadër të Iniciativës Globale për Kontrollin Progresiv të Sëmundjeve Ndërkufitare të Kafshëve (GF-TADs)

© OIE and FAO, 2021
CB6495SQ